



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr.____Prot.

Tiranë, më __.__.2021

Lënda : Mbi miratimin e planit të pranimit/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2021.

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 18, “Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil”, Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” si dhe Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nr. 58/2019, “Për disa ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 98/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”,

Bazuar në gjermën a) “Mbushjen e moshës së pensionit të nëpunësit civil” të pikës 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, në stafin e Komisionerit, për vitin kalendarik Janar-Dhjetor 2021, nuk ka punonjës që mbushim moshën e pensionit.

Bazuar në gjermën b) “Parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil”, të pikës 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, të gjitha pozicionet e punës janë të plotësuar në përputhje me strukturën dhe organikën e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, përjashtim bëjnë rastet e paparashikuara gjatë vitit, por të planifikuara në buxhetin e vitit respektiv.

Njësia Përgjegjëse:

Ollga Hodaj